

CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA SH.P.K

**Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(me raportin e audituesit të pavarur)**

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	1
Pasqyra e pozicionit financiar.....	2
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit.....	3
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.....	4
1. Informacion i përgjithshëm.....	5
2. Politikat kontabël.....	5
2.1 Bazat e përgatitjes.....	5
2.2 Parimi i vijmësisë.....	5
2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.....	6
2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet.....	6
2.5 Politika të rëndësishme kontabël.....	8
3. Manaxhimi i rrezikut financiar.....	15
3.1 Hyrje dhe të përgjithshme.....	15
3.2 Rreziku i kredisë.....	15
3.3 Rreziku i likuiditetit.....	15
3.4 Rreziku i tregut.....	17
3.5 Administrimi i kapitalit.....	17
3.6 Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi vlerën e drejtë.....	18
4. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa.....	18
5. Të ardhura dhe shpenzime nga tarifat dhe komisionet.....	18
6. Shpenzime personeli.....	18
7. Shpenzime administrative dhe të tjera.....	19
8. Tatimi mbi fitimin.....	19
9. Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to.....	20
10. Mjete dhe Pajisje.....	20
11. Aktive të tjera.....	20
12. Grante.....	20
13. Detyrime të tjera.....	21
14. Kapitali aksionar.....	21
15. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara.....	21
16. Aktivet monetare dhe ekuivalentet (afatshkurter).....	22
17. Ngjarjet pasuese.....	22

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR AKSIONARËT E CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA SHPK

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k ("Shoqëria") të cilat përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyrën e fluksit të parasë për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë pasaktësi materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është që, duke u bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasaktësi materiale.


Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015, të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri



31 mars 2016
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjeli
Ekspert Kontabël të Autorizuar



Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2015 LEK
Të ardhura nga interesi	4	24,802
Shpenzime për interesa	4	-
Të ardhura neto nga interesat		24,802
Të ardhura nga komisionet		-
Shpenzime për komisionet	5	(62,987)
Të ardhura neto nga komisionet		(62,987)
Të ardhura të tjera	13	3,333,611
Fitimi/(humbje) neto nga këmbimet valutore		136,123
Të ardhura të tjera operative		3,469,734
Zhvlrësimi neto i qirave financiare dhe huave ndaj klientëve		-
Zhvlrësimi dhe amortizimi i aktiveve afatgjata	10	(121,288)
Shpenzime personeli	6	(2,523,802)
Shpenzime administrative dhe të tjera	7	(1,796,836)
		(4,441,926)
Fitimi para fitimit		(1,010,377)
Tatimi mbi fitimin	8	-
Fitimi për periudhën		(1,010,377)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi mbi fitimin		-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(1,010,377)

Këto pasqyra financiare u miratuan më 31 Mars 2016 nga:


Eugen Lici
Drejtor i Përgjithshëm


Dorin Rama
Përgjegjës Finance dhe Kontabiliteti

Shënimet në faqet 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015 LEK
Aktivët		
Aktive monetare dhe ekuivalentët me to	9	53,814,628
Investimi në qira financiare, neto		-
Tatim fitimi i parapaguar		-
TVSH e arkëtueshme		614,980
Aktive të tjera	11	125,957
Tatimi i shtyrë, neto		-
Mjete dhe pajisje	10	2,426,329
Aktive jo-materiale		-
Totali i aktiveve		56,981,894
Liabilities		
Detyrime ndaj bankave dhe palëve të treta		-
Detyrime ndaj klientëve		-
Grante	12	2,822,389
Detyrime të tjera	13	430,122
Totali i detyrimeve		3,252,511
Kapitali		
Kapitali i paguar	14	54,739,760
Rezerva ligjore		-
Fitime të pashpërndara		(1,010,377)
Totali i kapitalit		53,729,383
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		56,981,894

Shënimet në faqet 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për periudhën 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i paguar LEK	Rezerva ligjore LEK	Fitime të pashpërndara LEK	Totali LEK
Gjëndja në 1 janar 2015	-	-	-	-
Fitimi i vitit			(1,010,377)	(1,010,377)
Të ardhura të tjera, neto nga tatimi mbi të ardhurat				-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	(1,010,377)	(1,010,377)
Rritje e kapitalit të nenshkuar e të paguar	54,739,760	-	-	54,739,760
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	-	-	-
Gjëndja në 31 dhjetor 2015	54,739,760	-	(1,010,377)	53,729,383

Shënimet në faqet 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për periudhën 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2015 LEK
Flukset monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi i periudhës		(1,010,377)
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	10	121,288
Të ardhura nga interesat, neto	4	(24,802)
Të ardhura nga granti	12	(3,333,611)
Diferencat e perealizuara nga kurset e këmbimit		(136,123)
		(4,383,625)
Ndryshimi në aktive të tjera		(740,937)
Ndryshimi në detyrime të tjera	13	430,122
Interesi i arkëtuar	4	2,201
Interesi i paguar		-
Tatim fitimi i paguar		-
Flukset monetare neto, nga aktivitetet operative		(4,692,239)
Flukset monetare përdorur në aktivitetet investuese		
Blerja e mjeteve dhe pajisjeve	10	(2,547,617)
Blerje të aktiveve jo-materiale		-
Grant i marre	12	6,156,000
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese		3,608,383
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Rrijte kapitali	14	54,739,760
Flukset monetare neto nga aktivitetet financiare		54,739,760
Rritje neto në aktivet monetare dhe ekuivalentët me to		53,655,904
Aktivitet monetare dhe ekuivalentët me to në 1 Janar		-
Efekti i ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi aktivet monetare dhe ekuivalentët me to		136,123
Aktivitet monetare dhe ekuivalent më 31 dhjetor	16	53,792,027

Shënimet në faqet 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k është një institucion financiar jo-banke i themeluar si Shoqëri me Përgjegjesi të Kufizuar me datë 07/01/2015 pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit në bazë të ligjit përkatës në fuqi. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 9901 datë 14/04/2008, "Për shoqëritë tregtare", si dhe nga statuti i saj dhe legjislati shqiptar në fuqi.

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18/12/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 8269, datë 23/12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" miratuar me vendim nr. 01, datë 17/01/2013 të Keshillit Mbikëqyres, Crimson Finance Fund Albania sh.p.k ka marrë licencën (nr. 34) me datë 02/10/2015 për ushtrimin e aktivitetit të saj si subjekt financiar jobanke.

Objekti i aktivitetit të Crimson Finance Fund Albania, i paraqitur pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit dhe Bankës së Shqipërisë është si vijon:

"Aktivitet i faktoringut / financim nepermjet urdher blerjes (purchase order finance), qera financiare, garanci dhe konsulence, ndërmjetesim, si dhe shërbime të tjera financiare ndihmese, asistencë teknike dhe trajnim për tregtarët, fermerët, dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri".

Me datë 31/12/2015 Crimson Finance Fund Albania operon në Tiranë dhe numri i punonjësve të saj ka qenë 4 (kater).

Adresa e regjistruar e zyrave qendrore të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k, si dhe qendra kryesore e biznesit ndodhet në rrugën Bardhok Biba, Godina e Vjeter Tirana, Hyrja 1, Kati 2, Tiranë, Shqipëri.

2. Politikat kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek (LEK), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek, rrumbullakosur në Lekun më të afërt.

(i) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

(ii) Paraqitja e pasqyrave financiare

Shoqëria e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Shoqërisë.

2.2 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që shoqëria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të shoqërisë, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

(i) Vlera e drejtë e instrumentave financiarë

Shoqëria nuk ka aktive ose detyrime që maten me vlerën e drejtë. Çmuarja me vlerë të drejtë kryhet vetëm për qëllime të pasqyrimit të këtij informacioni sipas kërkesave të standarteve të ndryshëm SNRF që përcaktojnë detyrimin e pasqyrimit të vlerës së drejtë për qëllim informacioni të përdoruesve të pasqyrave financiare.

Percaktimi i vlerës së drejtë është një nga fushat kryesore ku manaxhimi përdor vlerësime dhe gjykime, për arsye se asnjë nga aktivet apo detyrimet e Shoqërisë nuk ka një treg aktiv që mund të tregojë me besueshmëri vlerën e drejtë. Si rrjedhojë, manaxhimi është i detyruar të përdorë përlogaritje dhe supozime në lidhje me vlerën e drejtë të tyre.

Informacionet në lidhje me vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare që janë vlerësuar duke përdorur supozime të cilat nuk janë të bazuara në të dhënat e tregut të vëzhgueshme janë paraqitur në Shënimin 3.6.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka instrumentat financiarë, përveç zerave të llogarive rrjedhese, depozitave me afat dhe paradhenieve të ndryshme, të cilat maten me kosto të amortizuar.

2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet

(i) Standarde të publikuara që kanë hyrë në fuqi

Megjense Shoqëria është krijuar në 7 janar 2015, ajo ka aplikuar gjithë IFRS që kanë qenë efektive në atë datë dhe ndryshimet me të fundit që u bene të detyrueshme për herë të parë për vitin financiar që fillon me 1 janar 2015.

(ii) Standarde të publikuara që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe nuk janë adoptuar ende

Standardet e publikuara por që nuk kanë hyrë në fuqi në datën e publikimit të pasqyrave financiare, janë të listuara më poshtë. Ky është një listim i standardeve dhe interpretimeve të publikuara, të cilat Shoqëria në mënyrë të arsyeshme pret të jenë të aplikueshme në një datë të ardhme. Shoqëria pret të adoptojë këto standarde kur ato të hyjnë në fuqi.

• SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja

Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018, por lejohet adoptimi i hershem. Faza përfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. Drejtimi është duke vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi dhe nëse ky standard do të aplikohet më herët.

• SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017. SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve jo-financiare që nuk janë transaksione të veprimtarisë të zakonshme të njesise ekonomike (p.sh. shitja e aktiveve afatgjata material dhe jo-materiale). Dhënia e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshi ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në llogaritjen e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe vlerësimit. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin që standardi do të ketë, megjithatë nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

(ii) Standarde të publikuara që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe nuk janë adoptuar ende (vazhdim)

• SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshuar)

Ndryshimi behet efektiv nga data 1 janar 2016. Ky ndryshim do të lejojë entitetet të përdorin metodën e kapitalit për të llogaritur investimet në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe investime në pjesëmarrje në pasqyrat e tyre financiare individuale, si dhe do të ndihmojë disa juridiksione të lëvizin drejt SNRF, për pasqyrat financiare individuale, duke ulur kostot e përputhshmërisë pa zvogëluar informacion e disponueshëm për investitorët. Shoqëria nuk ka investime në njësi ekonomike të tjera dhe amendimi nuk do të ketë ndikim.

• Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38: Sqarimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit

Ndryshimet qartësojnë parimin në SNK 16 dhe SNK 38 që e ardhura pasqyron një model të përfitimeve ekonomike që është krijuar nga operimi i biznesit (në të cilin aktivi është pjesë) sesa përfitimet ekonomike nga konsumi nëpërmjet përdorimit të aktivit. Si rezultat, një metodë bazuar në të ardhurat nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar ndërtesat, pajisjet dhe mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuara për amortizimin e aktiveve jo-materiale.

• SNK 19 Përfitimet e Punonjësve

Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se sa vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, duhet të përdoren normat e obligacioneve qeveritare.

• SNK 1: Paraqitja e shënimeve shpjeguese (Ndryshuar)

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:

- materialitetin sipas kërkesave të SNK 1
- rreshtat specifik në të cilat mund të ndahet pasqyra e fitimit, humbjeve dhe të ardhurave të tjera dhe pasqyrën e pozicionit financiar,
- se subjektet kanë fleksibilitet për sa i përket rendit në të cilën ata paraqesin shënime për pasqyrat financiare
- se pjesa e të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit neto duhet të paraqiten si një zë në total, dhe të klasifikuar mes atyre artikujve që do apo nuk do të jenë më pas të riklasifikuar në fitim ose humbje

Për më tepër, ndryshimet qartësojnë kërkesat që zbatohen kur nëntotale shtesë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe deklaratën / deklaratat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016, me miratimin e hershme të lejuar. Këto ndryshime nuk priten të kenë ndonjë ndikim në Kompani.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë të gjitha periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

(i) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në datën e raportimit të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vilit. Aktivët dhe detyrimet jomonetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj, rivlerësohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja neto nga ndryshimi i kurseve të këmbimit paraqitet në zërin "Fitimi/(humbje) neto nga këmbimet valutore" në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse.

Kursi i këmbimit të aplikuar (nga LEK në njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore në fund viti më 31 dhjetor 2015 ka qenë si më poshtë:

	<u>31 /12/ 2015</u>
USD	125,79
EUR	137,28

(ii) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar.

Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat dhe shumat e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë bilancit të një mjeti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

(iii) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për komisionet dhe tarifat që lidhen kryesisht me komisione transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që merren shërbimet.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(iv) Pagesat e qirasë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Shoqëria si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë të shoqëria në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë ("leasing"). Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Shoqëria si një qiradhënës

Qiratë ku shoqëria transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si investim neto në qira financiare. Fillimi i qirasë është data më e hershme mes kontratës së qirasë dhe datës së angazhimit mes palëve për termat kryesore të qirasë. Në këtë datë:

- një qira klasifikohet si qira financiare dhe;
- përcaktohen shumat që do të njihen me fillimin e afatit të qirasë.

Fillimi i qirasë është data në të cilën qiramarrësi ka të drejtë të përdorë aktivin e blerë me qira financiare. Kjo është data e njohjes fillestare të qirasë (p.sh. njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve që rezultojnë nga investimi neto në qira financiare, sipas rastit). Në pasqyrën e pozicionit financiar, Shoqëria paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare neto. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara. Të ardhurat nga investimi neto në qira financiare të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të leasing-ut janë vlera e drejtë e aktivit, ose nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut. Shoqëria vlerëson krijimin e fondeve rezervë për zhvlerësimin e investimit neto në qira financiare, duke përdorur politikat e përdorura për zhvlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizueshme (p.sh. qiratë financiare, llogaritë e arkëtueshme), duke qënë se kredite dhe investimi neto në qira financiare kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

(v) Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

a. Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje në Pasqyrën e të Ardhurave Përmblëdhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në periudhën e ardhshme dhe zërat që nuk taten apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmblëdhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(v) Tatimet (vazhdim)

b. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivët tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivit të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivët e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Shoqëria pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

c. Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, përkatësisht.

Shoqëria beson se përlogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjithë vitet e ardhshme tatimore bazuar në shumë faktorë, përfshirë këtu interpretimin e ligjit tatimor dhe eksperiencën e viteve të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në gjykime dhe supozime të cilat mund të përfshijnë një sërë vendimesh në të ardhmen. Informacioni i ri që mund të shtohet mund t'a çojë Shoqërinë në një ndryshim të gjykimin të saj në lidhje me përshtatshmërinë e këtyre detyrimeve tatimore; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën ato janë bërë.

(vi) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

a. Data e njohjes

Të gjithë aktivët dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

b. Matja fillestare e instrumentave financiarë

Shoqëria fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet e dhena klienteve, depozitat, huatë e marra në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Të gjitha aktivët dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(vi) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

c. *Klasifikimi i aktiveve financiare*

Aktivet financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

- Mjetet monetare dhe ekuivalentë
- Hua dhe paradhënie për klientët
- Investimi neto në qira financiare

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe ç'rregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brënda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

d. *Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit*

Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emetuar nga shoqëria janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e Shoqërisë pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Shoqëria janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

e. *Hua dhe paradhënie klientëve*

Hua dhe paradhënie për klientët (përfshirë qiratë financiare) përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që Shoqëria nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që Shoqëria ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që Shoqëria gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që Shoqëria, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Kur Shoqëria është qiradhënëse në një marrëveshje qiraje që transferon të qiramarrësit të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që lidhen me pronësinë e një aktivi, marrëveshja paraqitet brenda huave dhe paradhënieve. Pas matjes fillestare me vlerën e drejtë, shumat e huave dhe paradhënieve për klientët janë matur më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma ekuivalente e skontimit të mjeteve monetare hyrëse dhe dalëse të ardhshme të vlerësuara gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet me njohjen fillestare të aktivit financiar ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet në vijimësi. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin tarifën e paguara apo të marra, transaksionet e paguara, dhe skontimet apo primet, të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto rritëse të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen, shitjen ose nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivit apo detyrimit financiar. Të ardhurat apo shpenzimet e interesit të përfshira në fitim ose humbje përfshijnë interesin nga aktivet ose detyrimet financiare me kosto të amortizueshme me një normë efektive të interesit.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(vii) Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

(viii) Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizioni kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet (njihet) nëpërmjet fitimit ose humbjes. Shoqëria fshin disa kredi dhe qira financiare kur ato përcaktohen si të pambledhshme.

(ix) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e instrumentit financiar përcaktohet si çmimi që do të përfitohet nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e mundur, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Shoqëria kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Shoqëria nuk ka instrumenta financiarë të matur me vlerën e drejtë. Për qëllime dhënieje të informacioneve shpjeguese në lidhje me vlerën e drejtë, Shoqëria ka përdorur modele vlerësimi aty ku ka të dhëna të observueshme tregu; nëse këto të dhëna nuk janë të disponueshme, atëherë Shoqëria ka përdorur gjykimin e saj në përcaktimin e vlerave të drejta të instrumentave financiarë.

Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(x) Aktivët monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivët monetare dhe ekuivalentët me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivët monetare dhe ekuivalentët me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

(xi) Aktive afatgjata materiale

a. Njohja dhe matja

Aktivët afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit. Kostot e

aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimit në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes, kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

b. Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që në të ardhmen Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në Pasqyrën Permbledhëse të të Ardhurave në momentin kur ndodhin.

c. Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në Pasqyrën e të Ardhurave Permbledhëse me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit përveçse për aktivet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivët e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	Jetëgjatësia	Amortizimi (%)
Pajisje elektronike dhe kompjutera	4 vite	25%
Pajisje, mobilje dhe pajisje zyre	5 vite	20%
Pajisje zyre	5 vite	20%

(xii) Aktive jomateriale

Programe kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Shoqëria njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(xii) Aktive jomateriale (vazhdim)

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, përveç aktiveve për tatime të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(xiii) Huamarrjet

Huamarrjet nga Ortaket janë burimet kryesore të financimit të Shoqërisë. Kur Shoqëria shet një aktiv financiar dhe hyn në një "marrëveshje riblerjeje" për t'a blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Huamarrjet nga Ortaket maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveçse në rastet kur Shoqëria zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostonë së amortizuar të një detyrimi financiar dhe i alokimit të shpenzimit të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skonton deri në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare, pagesat monetare të ardhshme të vlerësuar (përfshirë të gjitha taksat dhe shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (sipas rastit) përgjatë një periudhe më të shkurtër.

(xiv) Përfitimet e punonjësve

a. Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Organet publike shtetërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

b. Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Shoqëria gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në Shoqëri nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e paguara janë të regjistruar si detyrime.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Manaxhimi i rrezikut financiar

3.1 Hyrje dhe të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Crimson Finance Fund Albania ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- risku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Crimson Finance Fund Albania ndaj çdo risku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit të Crimson Finance Fund Albania.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut për Crimson Finance Fund Albania. Bordi Drejtues përbëhet nga 4 anëtarë, të cilët janë edhe Ortaket e Shoqërise.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Crimson Finance Fund Albania, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar perputhjen me kufizimet. Crimson Finance Fund Albania, nëpërmjet trajnimeve dhe standarteve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

3.2 Rreziku i kredisë

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë i aktiveve financiare më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	Ekspozimi maksimal bruto
	31 dhjetor 2015
	LEK
Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to	53,814,628
TVSH e arkëtueshme	614,980
Aktive të tjera	-
	54,429,608

3.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Crimson Finance Fund Albania nuk do të permbushë pagesën e angazhimeve që lindin nga detyrimet financiare.

Administrimi i rrezikut të likuiditeti

Qëndrimi i Crimson Finance Fund Albania në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të riskojë të dëmtojë emrin e mire.

Bordi Drejtues rishikon vazhdimisht situatën e likuiditetit të Crimson Finance Fund Albania dhe bën rekomandimet përkatëse.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqërore mbi pasqyrat financiare për periudhën nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Mënyrat kryesore të përdorura nga Crimson Finance Fund Albania për administrimin e riskut të likuiditetit janë raportet e likuiditetit dhe vlerësimi i "gap-it" (hendekut) për periudha specifike.

Luhatshmëria në tregjet financiare globale dhe shqiptare

Vazhdimi i krizës financiare dhe ekonomike botërore ka ndikim midis të tjerash edhe mbi zvogëlimin e tregjeve kapitale, uljen e likuiditetit në sistemin bankar dhe në momente specifike, edhe në rritjen e interesit të kreditimit ndërbankar dhe luhatshmërinë e tregjeve të letrave me vlerë. Zhvillime të tjera jo të favorshme të krizës mund të ndikojnë negativisht mbi pozicionin financiar dhe likuiditetin e Crimson Finance Fund Albania.

Shoqëria llogarit në baza tremujore raportin në vijim: aktivet likuide përmbi detyrimet afatshkurtra. Aktivet likuide përfshijnë paratë dhe ekuivalentet me të, depozitat afatshkurtra me bankat. Detajet e raportit të aktiveve likuide kundrejt detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese paraqiten si vijon:

Maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare

31 dhjetor 2015	Deri në 1 muaj		1 deri 3 muaj		3-6 muaj		6-12 muaj		1 deri 5 vjet		Mbi 5 vjet		Totali	
	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK
Aktivët Financiare														
Aktivët monetare dhe ekuivalentët me to	53,814,628	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	53,814,628
Aktive të tjera, përfshirë TVSH-në e arkëtueshme	614,980	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	614,980
Totali	54,429,608	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	54,429,608
Detyrime financiare														
Detyrime të tjera	430,122	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	430,122
Totali	430,122	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	430,122
Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2015	53,999,486	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	53,999,486
Kumulativi	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	53,999,486	-

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.4 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit dhe normat e kursit të këmbimit do të ndikojë në të ardhurat e Crimson Finance Fund Albania apo vlerën e instrumentave financiarë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Ne 31 dhjetor 2015 Crimson Finance Fund Albania nuk ka ndonjë rrezik ndaj ekspozimit kundrejt ndryshimeve në kursin e këmbimit.

Hendeku i maturitetit për monedhat kryesore përlogaritet dhe analizohet nga Crimson Finance Fund Albania mbi baza vjetore. Tabela e mëposhtme tregon një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të Crimson Finance Fund Albania më 31 dhjetor 2015 mbi bazën e maturitetit të mbetur:

31 dhjetor 2015	LEK	USD	EURO	Të tjera	Totali
Aktive					
Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to	48,992,753	-	4,821,875	-	53,814,628
Aktive të tjera, përfshi TVSH e arkëtueshme	614,980	-	-	-	614,980
Totali	49,607,733	-	4,821,875	-	54,429,608
Detyrime dhe kapitali i vet					
Detyrime të tjera	430,122	-	-	-	430,122
Totali	430,122	-	-	-	430,122
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2015	49,177,611	-	4,821,875	-	53,999,486

3.5 Administrimi i kapitalit

Shoqëria e administron kapitalin e saj duke siguruar vijimësinë e aktiviteteve të saj duke maksimizuar kthimin e aksionereve përmes optimizimit të tepricës së borxhit dhe asaj të kapitalit të vet.

Gjëndja e kapitalit dhe raportit të borxhit të Crimson Finance Fund Albania më 31 dhjetor 2015 ka qenë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 LEK
Huamarrja totale	-
Minus: Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to	(53,814,628)
Detyrime neto	(53,814,628)
Totali i Kapitalit Aksionar	54,739,760
Kapitali aksionar/detyrime neto	(101,72%)

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.6 Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi vlerën e drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë bazohet mbi instrumentat financiarë ekzistues të pasqyrës të pozicionit financiar, pa u përpjekur për të aktualizuar vlerën e bizneseve të ardhshme dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk janë instrumenta financiare.

Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllimin e dhënies së shënimeve shpjeguese.

Ne 31 dhjetor 2015 vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare eshte e perafert me vleren e tyre te mbetur.

4. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 LEK
Të ardhura nga interesat	
Hua dhe investime neto në qira financiare	-
Llogari dhe depozita bankare	24,802
Interes i përllogaritur mbi qira financiare të zhvlerësuara	-
<i>Totali i të ardhurave nga interesat</i>	24,802
Shpenzime për interesat	
Hua të tjera	-
Hua nga bankat	-
<i>Totali i shpenzimeve për interesat</i>	-
Të ardhura neto nga interesat	24,802

Te ardhurat nga interesat perbehen nga interesi i llogaritur mbi 2 depozita me afat (15,000 ALL dhe 30,000 ALL), me afat 30 dhe 40 ditor. Pjesa e mbetur perbehet nga interesi i perfituar (0.1%) mbi llogarite rrjedhese ne BKT, i kredituar me 31 dhjetor 2015.

5. Të ardhura dhe shpenzime nga tarifat dhe komisionet

Shpenzimet per tarifa dhe komisione perfshijne tarifa transfertash dhe pagesash te kryera, komisione mirembajtje llogarie si dhe nje komision i mbajtur nga Banka e Shqiperise per aplikimin per licence.

6. Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 LEK
Paga	2,293,028
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	230,774
	2,523,802

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

7. Shpenzime administrative dhe të tjera

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 LEK
Qira	768,418
Komisione ligjore dhe konsulenca	160,946
Artikuj zyre	138,410
Telekomunikacion	126,866
Shpenzime marketingu	100,700
Sherbime te jashtme	101,600
Karburant	50,333
Servis automjeti	32,070
Mirëmbajtje dhe riparime	54,539
Energji, ujë	37,028
Siguracion	16,341
Taksa	9,465
Të tjera	200,120
	1,796,836

8. Tatimi mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 LEK
Tatim aktual	-
Tatimi i shtyrë (përfilim)/shpenzim	-
Tatimi mbi fitimin	-

Ne përputhje me rregulloret tatimore shqiptare, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin per vitin 2015 eshte 15%. Rakordimi i normës efektive të tatim fitimit paraqitet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 LEK
Fitimi para tatimit	(1,010,377)
Tatimi i përlogaritur me 15%	(151,557)
Efekti i shpenzime të pazbritshme me 15%	47,187
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	(104,370)

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit tek Autoritetet Tatimore por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndrysho)

9. Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to

	31 dhjetor 2015 LEK
Llogari rrjedhëse me bankat dhe Arke	8,792,027
Depozita me bankat	45,000,000
Interes i përlogaritur	22,601
	53,792,027

10. Mjete dhe Pajisje

	Kompjuterat LEK	Pajisje për zyra LEK	Totali LEK
Kosto			
Gjëndja në 1 janar 2015	-	-	-
Shtesa	1,260,776	1,286,841	2,547,617
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-
Gjëndja në 31 dhjetor 2015	1,260,776	1,286,841	2,547,617
Zhvlerësim			
Gjëndja në 1 janar 2015	-	-	-
Zhvlerësimi i periudhës	(73,401)	(47,887)	(121,288)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-
Gjëndja në 31 dhjetor 2015	(73,401)	(47,887)	(121,288)
Vlera e mbartur			
Gjëndja në 1 janar 2015	-	-	-
Gjëndja në 31 dhjetor 2015	1,187,375	1,238,954	2,426,329

11. Aktive të tjera

	31 dhjetor 2015 LEK
Debitorë të tjerë, neto	-
Shpenzime të shtyra	125,957
	125,957

Zeri Shpenzime të shtyra përbehet nga parapagime të kryera për shërbime të tilla si Internet, Sigurim mjete dhe të ambjenteve të zyrës si dhe Karburant.

12. Grante

	7 Janar 2015 LEK	Fonde të Marra LEK	Te ardhura nga Grantet LEK	Diferenca nga kursi i kembimit LEK	Totali LEK
Grant (Norfund)	-	6,156,000	(3,333,611)	-	2,822,389
	-	6,156,000	(3,333,611)	-	2,822,389

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015
(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

13. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 LEK
Detyrime ndaj furnitoreve	243,181
Detyrime të tjera	90,489
Provizione për taksat	96,452
	430,122

14. Kapitali aksionar

Struktura aksionare e Crimson Finance Fund Albania më datë 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 LEK
Bashkia Tirane	13,750,000
Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit	13,750,000
Norfund	13,750,000
Crimson Capital	13,750,000
Kapital i Nenshkruar i Papaguar (Crimson Capital)	(260,240)
	54,739,760

Kapitali i Crimson Finance Fund Albania në 31 dhjetor 2015 përbëhet nga 4 kuota të shpërndara barazisht midis 4 Ortakeve: Bashkia Tirane, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, Norfund dhe Crimson Capital, me vlerë nominale prej 13,750,000 ALL secili. Një pjesë e kapitalit të nenshkruar nga Crimson Capital (260,240 ALL), mbetet ende e papaguar.

15. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara

Angazhimet për qiratë

Crimson Finance Fund Albania ka marrë me qira zyra në Tiranë. Angazhime të ardhshme të qirasë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 LEK
Jo më shumë se një vit	2,755,694
Mes 1 -5 vjet	11,690,824
Mbi 5 vjet	-
	14,446,518

Angazhimet për qirate janë të anulueshme me një marrëveshje mirekuptimi midis Qiradhenesit dhe Qiramarrës për prishjen e kontratës. Pagesa e Qirase kryhet në monedhen Euro. Kursi i kembimit i përdorur për parashikimin e angazhimit në LEK është EUR/ALL = 140. Angazhimi maksimal që do të rezultonte nga kjo kontratë është 14,446,518 LEK.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për periudhen nga 7 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, kur nuk është shprehur ndryshe)

16. Aktivet monetare dhe ekuivalentet (afatshkurter)

Per qëllime te raportimit te pasqyres se flukseve te parase, zeri i aktiveve monetare dhe ekuivalentet perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2015 LEK
Llogari rrjedhëse me bankat dhe Arke	8,792,027
Depozita me bankat	45,000,000
	53,792,027

Ketu nuk perfsihet vlera e interesit te perlogaritur e cila nuk eshte realizuar ende me 31 dhjetor 2015 dhe nuk ndikon ne flukset e parase.

17. Ngjarjet pasuese

Drejtimi i Crimson Finance Fund Albania nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë korigjim apo shënim shtesë në pasqyrat financiare.